



REPubLIKA E SHQIPERISË
Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale
Komisioneri

Nr. 133/1 Prot

Tiranë, më 10/2/2014

Lënda: Kthim përgjigje.

Drejtuar: Z. Dritan Spahiu

Drejtoria e Politikave dhe Zhvillimit të Hidrokarbureve

MINISTRIA E ENERGISË DHE INDUSTRIË

TIRANË

I nderuar z. Spahiu,

Më datën 28.01.2014 ka ardhur pranë këtij Autoriteti kërkesa juaj “*për interpretim në lidhje me publikimin nga IQT-ja e emrave të kompanive që abuzojnë me cilësinë e karburanteve*”.

Është shumë e rëndësishme që institucionet publike të kenë kujdes mbi gjetjen e ekuilibrit të duhur ndërmjet të drejtës për informim të publikut dhe mbrojtjes së të dhënave personale.

Publikimi i emrave të kompanive nuk mund të konsiderohet shkelje e privatësisë, pasi në kuptim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “*Për mbrojtjen e të dhënave personale*”, i ndryshuar, kompanitë janë kontrollues të të dhënave personale sepse mbledhin, ruajnë, përhapin apo i transferojnë këto të dhëna, pra përpunojnë të dhëna personale, si dhe kanë detyrimin ligjor të njoftojnë pranë Komisionerit për përpunimin e të dhënave personale që ato kryejnë.

Transparenca për të mbrojtur interesat e subjekteve të të dhënave (në këtë rast të konsumatorëve), duhet konsideruar e rëndësishme. Në këtë rast jemi përpara të drejtës për informimin e publikut, që është një e drejtë që buron nga detyrimi ligjor sipas nenit 9 të ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011 “*Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë*”, ku parashikohet se: “*Inspektorati informon publikun për konstatimet dhe masat e marra gjatë procedimit administrativ të inspektimit, nëse kjo është e nevojshme për mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të personave fizikë dhe juridikë*”.

Ju si kontrolluesit duhet të ndërmerrni iniciativa ligjore ose të vendosni rregulla të cilat nuk bien ndesh me zbatimin e ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar dhe njëkohësisht të plotësoni detyrimin ligjor për të drejtën e publikut për informim.

Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale ka publikur në faqen e tij zyrtare në internet www.kmdp.al, OPINIONIN mbi “*Transparencën e Publikimit të të dhënave të subjekteve tregtare abuzuese nga ana e Institucioneve Publike*” dhe do të mirëpresë çdo veprim tuajin për të bashkëpunuar, me qellim plotësimin e kërkesave ligjore në fushën e mbrojtjes të të dhënave personale.

Duke Ju falënderuar për mirëkuptimin dhe bashkëpunimin,

KOMISIONERI

FLORA ÇABEJ (POGAÇE)

